

BASHKIA KORÇË
NJOFTIM PËR DHËNIEN ME QIRA

Bashkia Korçë ka filluar procedurat për dhënie me qira me anë të procedurave të konkurrimit të sipërfaqes prej 2430 m², pasuria me nr.1/861 ZK 8561 me vendodhje në rr.Rilindasit, përballë Parkut Rinia, në pronësi të Bashkisë Korçë.

Kjo sipërfaqe jepet me qira me qëllim ushtrimin e veprimtarive të ndryshme tregtare.

Çmimi dysheme për fillimin e konkurrimit është 25 lekë/m² në muaj.

Afati i dhënies me qira është 1 (një) vit.

Vlerësimi i konkurrentëve do të bëhet sipas këtyre pikëve:

Tarifa mujore e qirasë:	50 pikë
Punësimi:	20 pikë
Investimi:	30 pikë

Konkurrimi do të bëhet në datën 05.01.2026, ora 10:00 në ambjentet e Bashkisë Korçë.

Dokumentacioni që do të paraqesin konkurrentët për konkurrim përmban:

1. Kërkesën e subjektit për marrje me qira, ku të deklarohet:
 - a. oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë,
 - b. qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore,
 - c. treguesit e konkurrimit, të parashikuar sipas planit të biznesit.
2. Plan-biznesin e hollësishëm në të cilin duhet të përfshihet informacioni i mëposhtëm:
 - a. Identiteti i subjektit kërkues, historiku i aktivitetit që kryen;

- b. Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;
- c. Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues, si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;
- d. Niveli i punësimit, që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara.
- 3. Deklarata në formën e vetëdeklarimit, si më poshtë vijon:
 - a. Deklaratë për të dhënat e Nuis/Nipt të subjektit kërkuar;
 - b. Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimet shoqërore;
 - c. Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;
 - d. Në rastet kur subjekti konkurrues zhvillon aktivitet me qira ose enfiteozë, në objekte pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt, të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;
 - e. Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim. Në rast konstatimi të të dhënave të rreme, në çdo rast, komisioni e skualifikon subjektin konkurrues.